



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-20763

Dt.21.11.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Sadri (Rrustem) Morina**, nga Gjakova për dhënien e Lejes së Ndërtimit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me etazhitet P+3, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 nenit 21, 44 dhe 97, bien këtë:

AKTVENDIM

I. ILEJOHET: Investitorit: Sadri (Rrustem) Morina nga Gjakova ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë me destinim, objekt banimor - shumë banesor, me afarizëm në përdhese, Sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Urbanistik “Veriu” dhe Kushtet Ndërtimore për rregullimin e hapësirës, me nr.07-351/01-4749, dt.05.04.2017, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 29/1, ZK: Gjakovë – Qytet (gjendja e re), në pronësi të lartëpërmendurit, në rrugën “Nëna Tereze”, e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është P+3, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) te objektit $S=469.53\text{ m}^2$

Përdhesa:	(Sip,Bruto):	$S=109.86\text{ m}^2$
Kati i parë:	(Sip,Bruto):	$S=119.89\text{ m}^2$
Kati i dytë:	(Sip,Bruto):	$S=119.89\text{ m}^2$
Kati i tretë:	(Sip,Bruto):	$S=119.89\text{ m}^2$

II. Hartimin e projektit për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja projektuese ndërtimore “Real - PROJECT”- Gjakovë.

III. Pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi është lokacioni i objektit i prezantuar grafikisht në Plan Situacion me të gjithë parametrat, i cili është i miratuar nga kjo drejtori, i njëjti është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

IV. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

V. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.



Ar sy e t i m

Sadri (Rrustem) Morina, nga Gjakova, me banim në rrugën "Nëna Tereze" nr.61/1, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-20763, të datës 27.09.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt banimor shumë banesor, me afarizëm në përdhese, me etazhitet të objektit P+3, në ngastrën kadastrale ndërtimore me numër 29/1, ZK: Gjakovë – Qytet, në rrugën "Nëna Tereze", siç është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:500, të datës 10.03.2017, të vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 15.11.2017, në pronësi të Sadri (Rrustem) Morina nga Gjakova, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Certifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 5993/17, të datës 15.11.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Kushtet Ndërtimore me numër 07-351/01-4749, të datës 05.04.2017 të lëshuar nga DUMM.
5. Pëlqimin për ndërtim nga Kreditori – "TEB"SH.A., i datës 11.04.2017.
6. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit shumë banesor, në ngastrën kadastrale me nr. 29/0, me investitor Sadri Morina, të hartuar nga "Geomerkur" Sh.p.k.Gjakovë, prill 2017..
7. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.155/17 me datë 18.07.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit emergjent, Departamenti i Parandalimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.
8. Pëlqimin Sanitar me nr.14/530/01-17190, dt.21.08.2017, nga Inspektorati Sanitar Komuna, Drejtoria për Punë Inspektuese e Komunës së Gjakovës.
9. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, numër 430-L-428 të datës 30.01.2017.
10. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, me nr.864, të datës 15.05.2017.
11. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, me nr.1292, të dt 05.05.2017.
12. Pëlqimin nga PTK- Sh.A.nr.41,Gjakovë, të datës 14.01.2017.
13. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Bankën për Biznes filiali në Gjakovë, të datës 10.11.2017.
14. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar ndërmarrja projektuese ndërtimore "Real - PROJECT"- Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 1793.47 Euro.


KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.


Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspektionit,
- Arkivit.

Zyrtar i Lartë për Çështje Juridike


Zenel Shabani, jur. i dipl.

U.D. Drejtori


Elida Bejtullahu, inxh. e dipl.e ark.



Ng. nr.29-0.




KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë Qytet

Shk. zvog. 1: 500

Poseduesi: Morina Sadri (Rrustem)
nga Gjakova




Në munges të planit original ipet ne tersi parcella

Numri rendor i regjistrit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
29/1			Shtepi-Oborr		0	01	52	
Gjithësejtë					0	01	52	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastër duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 15.11. të vitit 2017



VËRTETON: